



| | | | |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Priljenj/Prodato Received / Delivery | 18 - 04 2023 | 3 | viti god year |
| Organi / Njesia Org / Jedintca Org / Unit | Hr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKPMISHUK | 3654/2023 | | 113 |



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.453/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.453/2023 të datës 03.03.2023, të parashtruar nga ankuesja në çështjen juridike "shkelje e së drejtës në pagë", në mbështetje me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 14.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.453/2019 e datës 03.03.2023, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Gjykatën Themelore në Gjilan, më datë 03.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që ti njihet e drejta e harmonizimit të koeficientit të pagës nga koeficienti nëntë (9) në koeficientin trembëdhjetë (13), me pozitat ekuivalente të njëjta nga emërtimi dhe përgjegjësitë menaxhuese në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor dhe pagesës retroaktive nga data e akt emërimit pafat.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses të Këshillit Gjyqësor i Kosovës, ndërsa ky i fundit më datë 13.04.2023 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2289/2023 të datës 03.03.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; E-malin e datës 31.01.2023 i B. Gashi drejtuar Vendimin me numër KGJ.Nr.01/2023 të datës 18.01.2023 të Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të

Kosovës; Kontratën e marrëdhënies se punës të datës 25.10.2010; Akt emërimit 03-112-311 të datës 28.12.2012; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 2416/2023 të datës 07.03.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 13.04.2023; Vendimin me numër 366/2017 të datës 27.12.2017; Akt emërimit me numër të protokollit 03/185 të datës 07.04.2014; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e punës Udhëheqës i Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve; Listën e pagave të muajit Janar-2023; Listën e Pagave të muajit Shkurt-2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale lidhur me këtë çështja juridike, ka konstatuar që ankesa e ankueses *është e palejuar, sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës përkatësisht sipas Aktit të Emërimit me numër reference 03112/311 të datës 28.12.2012, rrjedhë së ankuesja ushtron pozitën e punës Shef i Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve, në Gjykatën Themelore në Gjilan. E njëjta më datë 17.01.2023 ka pashtuar kërkesë të Drejtorit i Departamentit të Administratës së Përgjithshme në Sekretariatit Gjyqësore të Kosovës (*tutje SKGJK-ja*) lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës më pozitë ekuivalente dhe përgjegjësi menaxhuese të njëjta në SKGJK, ndërsa ky i fundit në përgjigje të datës 31.01.2023 ka informuar ankuesen se: *Këshilli Gjyqësor i Kosovës në pajtim me ligjin e pagave, me datë 18.01.2023 ka nxjerr vendimin KGJK Nr.01/2023 për klasifikimin e vendeve të punës për të punësuarit në gjyqësor ku pozitë Udhëheqëseve të Zyrave në Gjykatë janë klasifikuar në Emërtimin e pozitës Drejtues/ i ulet grupi klasa J14 koeficienti 7.5 (barasvlershme me udhëheqësit e divizioneve në SKGJK), prandaj kërkesa juaj në këtë rast është përmbushur nga ana e KGJK-së”.*

Ankuesja e pakënaqur me përgjigjen e datës 31.01.2023 të Drejtorit të Departamentit të Administratës së Përgjithshme në Sekretariatit Gjyqësore të Kosovës, ka pashtuar drejtpërdrejt ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me pretendimin ankimor që ti njihet e drejta e harmonizimit të koeficientit të pagës nga koeficienti nëntë (9) në koeficientin trembëdhjetë (13), me pozitë ekuivalente të njëjta nga emërtimi dhe përgjegjësitë menaxhues në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor dhe pagesës retroaktive nga data e akt emërimit pafat.

Lidhur me pranueshmerinë e ankesës Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të nenit 81 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës më të cilat është përcaktuar se: *1.Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë. 2. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, si dhe dispozitave të nenit 4 paragrafi 1 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave më të cilin është specifikuar se: nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje apo lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës”, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi së ankuesja në rast të pakënaqësisë me përgjigjen e datës 31.01.2023 të Drejtorit të Departamentit të Administratës së Përgjithshme në Sekretariatit Gjyqësore të Kosovës lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës, e njëjta është dashur që të ushtroj fillimisht ankesë të brendshme gjegjësisht në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave pranë Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, e me tej në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.*

Ndërlidhur si me lart, Kolegji i Këshillit ju referua edhe Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përkatësisht nenit 16 paragrafit 4 me të cilin është përcaktuar se: *Para parashtrimt të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shterur procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, andaj, duke qenë se me asnjë provë nuk dëshmohet se ankuesja të ketë ushtruar paraprakisht ankesë të brendshme gjegjësisht në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të SKGJK-se, rrjedhë së ankesa e ankueses A.nr.453/2023 është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Theksuar si më lartë, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.453/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.